



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-14-5101

Parashtruesi i ankesës: A R, të cilën e përfaqëson av B I nga Prishtina

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit Prishtinë, rruga „Dritan Hoxha” nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën: 25.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e ushtruar nga A R vërtetohen si të drejt dhe të bazuara në ligj vendimet me shkrim me numër PRZ035/0180/78, i datës: 01.10.2013, i lëshuara nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Pranë DHPGJS është parashtruar ankesa e parashtruesit se bashku me grupin e punëtorëve prej 92 si ankesë grupore, kundër palës kundërshtare në lidhje me Vendimet e Autoritetit të Likuidimit të NSH Komuna-Prizren në likuidim, me të cilat janë refuzuar kërkesat kreditore punëtorëve, të parashtruara para Autoritetit të Likuidimit. Kjo lëndë ka pasur shenjën C-IV-13-2716, por për shkak të Urdhrit të Dhomës për ndarje të saj, më dt. 02.07.2014, kjo lëndë është evidentuar me numër C-IV-14-5101.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se ka punuar në ndërmarrje nga data 26.05.1969, e deri me datën 27.03.2007, ndërsa me datën 27.03.2007, si rrjedhojë e procesit të privatizimit pala kundërshtare ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Bordi i drejtorëve e ka miratuar vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit të ndërmarrjes duke filluar nga data 06.03.2008. Me datën 12.05.2008, një numër i punëtorëve përfshirë edhe parashtruesin e ankesës kanë parashtruar një kërkesë kolektive pranë Autoritetit të Likuidimit ku kanë kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit me datën 27.06.2013, i ka dërguar një shkresë përfaqësuesit të punëtorëve

ku ka kërkuar autorizimin e noterizuar për 92 punëtor të cilët i ka përfaqësuar pranë Autoritetit të Likuidimit. Me datën 10.07.2013, përfaqësuesi i punëtorëve e ka njoftuar Autoritetin e Likuidimit se është e pa mundur që në afatin kohor të përcaktuar të sjellë autorizimin e noterizuar. Rrjedhimisht Autoriteti i Likuidimit ka nxjerrë vendim në lidhje me parashtruesin e ankesës me të cilin kërkesën e ka refuzuar si të pa bazuar.

Me tutje në ankesën e parashtruar ka theksuar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit është nxjerrë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të të drejtës materiale. Në lidhje me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale ka theksuar se me rastin e vendosjes ka shkelur dispozitat e procedurës administrative. Në lidhje me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës ka bërë vlerësimin jo të plotë të gjendjes faktike. Është fakt i pa kontestueshëm se deri të ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur si rezultat i procesit të privatizimit të ndërmarrjes. Po ashtu është e pa kontestueshme se ndërmarrja nuk e ka kontestuar faktin se pagat nuk ju janë paguar punëtorëve. Ndërsa sa i përket zbatimin e gabuar të të drejtës materiale ka theksuar se si rezultat i konstatimit të gabuar të gjendjes faktike ka ardhur deri të zbatimi jo i drejtë i dispozitave materiale juridike. Autoriteti i Likuidimit e ka zbatuar nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Mirëpo ky ligj nuk ka qene në fuqi në vitin 1989, në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet. Me nenin 196, të Ligjit për Ndërmarrjes është e përcaktuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ligji për Punën e Bashkuar nuk do të gjej zbatim.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar ta aprovoj në tërësi si të bazuar, të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit i NSH Komuna me nr.PRZ035-0180/78; të detyrohet pala kundërshtarë që në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga data 01.01.2004, e deri me datën 31.12.2005, parashtruesit të ankesës t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,804.00 €.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e vendimit të marrë nga AKP-ja me nr.PRZ035-0180/78, për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i ankesës për kompensimin e pagave për periudhën janar 2004-dhjetor 2005;*
- *Deklaratën e parashtruesit të ankesës;*
- *Libri i Pranimit i NSH-së;*
- *Njoftimin e Likuidimit të lëshuar nga AKP-ja;*
- *Njoftimin e AKP-së, drejtuar parashtruesit të ankesës të datës 27.03.2007;*
- *Listën e pagave;*

Me datën 15.11.2021, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen ndaj ankesës së parashtruar nga A R. Në mbrojtje ndër të tjera ka theksuar se Ndërmarrja Shoqërore Komuna (në likuidim), ka hyrë në procesin të likuidimit me datën 06.03.2008. Parashtruesi i ankesës ka parashtruar një kërkesë përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagave për periudhën janar

2004-dhjetor 2005. Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRZ035-0180/78, e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave. Autoriteti i Likuidimit vendimin e vetë e ka bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034, dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se kërkesa kolektive është parashtruar me datën 12.05.2008, nga përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës dhe atë në emër 119 punëtorëve të ndërmarrjes. Mirëpo kërkesa nuk përmbante autorizimin e vlefshëm në lidhje me përfaqësuesin e punëtorëve. Autoriteti i Likuidimit me datën 17.06.2013, i ka dërguar një letër përfaqësuesit të punëtorëve ku i ka kërkuar prezantimin e autorizimit në formë të rregullt noterial për 119 punëtorë. Përfaqësuesi i punëtorëve është përgjigjur në kërkesën e Autoritetit të Likuidimit me datën 10.07.2013, dhe ka shprehur pamundësinë e mbledhjes së të gjithë punëtorëve për të marrë autorizimin. Rrjedhimisht Autoriteti i Likuidimit ka shqyrtuar kërkesat e parashtruara si kërkesa të parashtruara në mënyrë individuale.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike të çështjes e po ashtu drejtë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi me ankesën e parashtruar nuk ka treguar se cila dispozitë ligjore e Ligjit me nr.04/L-034, për AKP-në, nuk është respektuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit.

Në pajtim me qëndrimet e vetë parashtruesit, vendimi i Autoritetit të Likuidimit nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të ligjit të cituar me lartë. Në rastin konkret pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të parashkruara, ngase për ta ndërprerë parashkrimin kërkesa është dashur të paraqitet në gjykatë apo në ndonjë organ tjetër kompetent brenda afatit pre tri viteve nga momenti kur NSH-ja të mos ketë përmbushur kërkesat eventuale të parashtruesit e që në rastin konkret parashtruesi pretendon në kërkesë e cila është e vitit 2004.

Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të ankesës në lidhje me zbatimin e te drejtës materiale ka theksuar se ky pretendim nuk qëndron për faktin se me Ligjin për Ndërmarrjet janë shfuqizuar vetëm apo dispozita ligjore të Ligjit për Punën e Bashkuar të cilat bie ndesh me dispozitat e këtij ligjit.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar nga A R ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit me nr.06/L-086.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar nga pala paditëse është e pa bazuar.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se ankuesi me datën 12.05.2008, pranë Autoritetit të Likuidimit përmes përfaqësuesit të parashtruesit të ankesës së bashku 119 punëtorëve të ndërmarrjes, kanë parashtruar kërkesë për kompensim të pagave. Mirëpo kërkesa nuk përmbante autorizimin e vlefshëm në lidhje me përfaqësimin e punëtorëve. Autoriteti i Likuidimit me datën 17.06.2013, i ka dërguar një letër përfaqësuesit të punëtorëve ku i ka kërkuar prezantimin e autorizimit në formë të rregullt noterial për 119 punëtorë. Përfaqësuesi i punëtorëve është përgjigjur në kërkesën e Autoritetit të Likuidimit me datën 10.07.2013, dhe ka shprehur pamundësinë e mbledhjes së të gjithë punëtorëve për të marrë autorizimin. Rrjedhimisht Autoriteti i Likuidimit ka shqyrtuar kërkesat e parashtruara si kërkesa të parashtruara në mënyrë individuale. Ku pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga parashtruesi i ankesës në atë procedurë Autoriteti i Likuidimit me vendimin e kontestuar e ka refuzuar kërkesën e parashtruar mbi bazën e parashkrimit të kërkesës.

Parashtruesi i ankesës me ankesën grupore po ashtu edhe me ankesën individuale të dorëzuar e ka kontestuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me pretendimin se kërkesa e parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit nuk është e parashkruar dhe se Autoritetit i Likuidimit në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitat ligjore në lidhje me parashkrimin. Pala kundërshtare përmes mbrojtjes së parashtruar në këtë çështje ka pretenduar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit është në përputhje me dispozitat ligjore dhe se kërkesa e pretenduar e parashtruesit është e parashkruar. Pas shqyrtimit të provave të lëndës rrjedh se parashtruesi i ankesës ka pretenduar në borxh-pagat e që i referohet periudhes kohore janar 2004, e deri në dhjetor 2005, ndërsa kërkesën pranë Autoritetit të Likuidimit është parashtruar një kërkesë kolektive nga A V me datën 12.05.2008. Mirëpo i njëjti nuk ka prezantuar autorizimin e vlefshëm pranë Autoritetit të Likuidimit edhe pas kërkesës së parashtruar nga Autoriteti i Likuidimit me datën 17.06.2013, për sjellje të autorizimit. Rrjedhimisht Autoriteti i Likuidimit i ka shqyrtuar kërkesat në mënyrë individuale.

Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të ankesës pranë Autoritetit të Likuidimit është parashtruar pas kalimit të afatit prej tri viteve, duke u bazuar në nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërbimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”, gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar nga A R është e parashkruar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimin të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi